



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.99 dt.03.07.1998

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.03.07.1998, pasi shqyrtoi Relacionin e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik (Seksionit të Transportit) dhe Drejtorisë Administrimit Financiar “Mbi çeljen e fondit për vendosjen e tabelave të qarkullimit rrugor dhe shenjave dalluese në territorin e Parkut të Madh Kombëtar për ndërmarrjen e specializuar Q.E.K.Dekorit Tiranë”, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal”, dhe Nr.7776, dt.22.12.1993, “Për Buxhetin Lokal”

VENDOSI

1. Të çelet fondi prej 70.000 lekë për vendosje tabelash qarkullimi i shenjave dalluese në territorin e Parkut të Madh Kombëtar.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik (Sektori i Transportit) dhe Drejtoria e Financës në Bashkinë e Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI